



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 22490 prot.

Shkodër, më 03.11. 2025

VENDIM

Nr. 62, datë 31.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË
DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2025”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të nenit 38 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; të pikës 4/a të VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; të Urdhrit nr. 1209, datë 02.10.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për testimin në tregun e lirë të çmimeve të qirasë mesatare mujore të banesave sipas strukturave përkatëse në zonat rurale dhe urbane për procedurën ‘Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë’”; të procesverbalit të Komisionit mbi testimin e tregut nr. 4029/b prot., datë 14.10.2025, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në zonat urbane dhe ato rurale në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1	Banese me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1	18,700	18,000

2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	muaj	1	27,500	21,667
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	muaj	1	39,800	32,167
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	muaj	1	52,700	41,667

2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë përcaktohet në nivelin e qirasë mesatare mujore në tregun e lirë, sipas vlerave të miratuara në këtë vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 37 vota

Vota Pro 37
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 03.11.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj


